

AGJENCIONI PËR PUNËSIM

2696.

Në bazë të nenit 90 paragrafi 1 nga Ligji për punësim dhe sigurim në rast të papunësisë ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" Nr.37/97, 25/00, 101/00, 50/01, 25/03, 37/04, 4/05, 50/06, 29/07, 102/08, 161/08, 50/10, 88/10, 51/11, 11/12, 80/12, 114/12, 39/14, 44/14, 113/14, 56/15, 129/15, 147/15, 154/15, 27/16, 119/16, 21/18, 1131/18 dhe "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut", Nr.124/19) Këshilli drejtues i Agjencionit për punësim i Republikës së Maqedonisë së Veriut, në seancën e mbajtur më 28.06.2019, solli:

SOLLI VENDIM STATUTOR PËR PLOTËSIM DHE
NDRYSHIM TË STATUTIT TË AGJENCIONIT PËR PUNËSIM
NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË

Neni 1

Në Statutin e Agjencionit për punësim në Republikën e Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 10/98, 16/99, 46/01, 34/02, 57/04, 22/08, 118/2012, dhe 45/15) Në titullin dhe në gjithë tekstin e statutit pas fjalës "Republika" shtohet fjala "E veriut".

Në gjithë tekstin e Statutit fjala „punëdhënës” ndryshohet me fjalën „punëdhënësi”, ndërsa fjala „punëdhënësit” ndryshohet në fjalën „punëdhënësit”

Neni 2

Në nenin 4 pika 1 paragrafi 5, pas fjalëve „personat e papunësuar” shtohen fjalët „dhe personat tjerë që kërkojnë punë”.

Në paragrafin e 6 pas fjalëve „person i papunësuar” shtohen fjalët „edhe person tjetër që kërkon punë”

Në paragrafin 8, pas fjalëve „personat e papunësuar” shtohen fjalët „dhe personat tjerë që kërkojnë punë”.

Neni 3

Neni 16 fshihet.

Neni 4

Në nenin 17 pika 1 paragrafi 14 fjalët „punëtorët e” ndryshohet me fjalët „të punësuarit në”

Pas pikës 1 shtohet pik 2 dhe do të shkruaj:

“Drejtori i Agjencionit për punësim nga detyra e përcaktuara në kompetencë të tij mundet të autorizoj t'i kryejnë punët nëpunësit administrativ udhëheqës”.

Neni 5

Neni 18 në pikën 3 fjalët (15 qershor) ndryshohen me fjalët “1 shtator”

Neni 6

Në nenin 23 në pikën 1 fjalët “punëtorët në shërbimet profesionale” ndryshohen me fjalët “të punësuarit në Agjencionin për punësim”.

Në pikën 2, pika në fund të fjalës fshihet dhe shtohen fjalët “për nëpunësit administrativ, ndërsa Komisioni shtetërorë për vendosje në procedurë administrative dhe marrëdhënie pune në shkallën e dytë për të punësuarit në Agjencionin për punësim të cilët nuk kanë statusin e nëpunësve administrativ”.

Neni 7

Neni 24 ndryshohet dhe do të shkruaj:

Të punësuarit në Agjencionin për punësim të cilët kryejnë punë me karakter publik të përcaktuar me Ligjin për punësim dhe sigurim në rast të papunësisë të cilët kanë statusin e nëpunësve administrativ, në raport me të drejtat e tyre,

detyrimet dhe përgjegjësitë zbatohen në bazë të dispozitave të Ligjit për punësim dhe sigurim në rast të papunësisë, Ligji për nëpunësit administrativ dhe Ligji për të punësuarit në sektorin publik.

Të punësuarit në Agjencionin për punësim që kryejnë shërbime nga veprimtaria e punës, respektivisht ata që kryejnë shërbime në ndihmë dhe mbështetje për pjesëmarrësit në tregun e punës dhe të cilët kanë status të dhënësit të shërbimeve publike nga veprimtaria e punës, në raport me të drejtat e tyre, detyrimet dhe përgjegjësitë nga Ligji për marrëdhënie pune zbatohen dispozitat e Ligjit për punësim dhe sigurim në rast të papunësisë, të punësuarit në sektorin publik si dhe rregulloret e përgjithshme nga sfera e marrëdhënies së punës.

Të punësuarit në Agjencionin për punësim të cilët kryejnë punë teknike ndihmëse dhe të cilët nuk kanë status të nëpunësve administrativ, në raport me të drejtat e tyre, detyrimet dhe përgjegjësitë nga marrëdhënia e punës do të zbatohen dispozitat e Ligjit për punësim dhe sigurim në rast të papunësisë, të punësuarit në sektorin publik si dhe rregulloret e përgjithshme nga sfera e marrëdhënies së punës.

Neni 8

Në nenin 25 pika në fund të fjalës fshihet dhe shtohen fjalët “ atje ku personi i papunësuar është evidentuar”

Neni 9

Në nenin 26 fjalët “dhe përgadit vendime udhëheqësi i “ fshihet, ndërsa fjalët “në të cilën” dhe ndryshohen me fjalët „ku”.

Neni 10

Në nenin 27 pika 2 paragrafi 2 ndryshohet dhe do të shkruaj: “-informimi i punëdhënësve dhe personat e papunësuar dhe prsonat tjerë që kërkojnë punë”.

Neni 11

Në nenin 30 pika 2 fjalët “ dhe për aktet për sistematizim dhe organizim “ fshihen.

Pas pikës 2 shtohet pika 3 e cila do të shkruaj:

“Pëlqim për aktet për sistematizim dhe organizim të vendeve të punës në Agjencionin për Punësim, jep ministri për shoqëri informatike dhe administratë.

Neni 12

Ky vendim statutor hyn në fuqi ditën e ardhëshme nga dita e publikimit në “Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut” ndërsa do të publikohet pas marrjes së pëlqimit nga ana e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Nr. 02-2371

28 qershor 2019

Shkup

Kryetar

i këshillit drejtues

Angel Dimitrov